

V E N D I M

Nr.328, datë 12.7.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.446, DATË 9.7.1998 "PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në kapitullin I bëhen këto ndryshime:

Pika C) 1 formulohet:

"Agjencia Kombëtare e Privatizimit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, brenda 20 ditëve bën llogaritjet për pjesën e kapitalit themeltar të shoqërisë, që përbën paketën e aksioneve për punonjësit e shoqërisë e për ish-pronarët e truallit dhe ia dërgon Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit."

Shtohet pika 5, si më poshtë:

"Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, kur gjykon se nuk cenohen interesat e punonjësve dhe të ish-pronarëve, urdhëron shitjen e paketës shtetërore. Në këtë rast procedurat fillojnë nga kapitulli II."

Në kapitullin II pikat B) 6 dhe B) 7 bashkohen dhe riformulohen:

"Brenda 45 ditëve nga dita e mbylljes së ankandit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit jep rezultatin përfundimtar për secilin pjesëmarrës në ankand. Mënyra e shpërndarjes së kapitalit të paketës së aksioneve për publikun do të jetë ajo përpjesëtimore, sipas rezultateve përfundimtare të raportit ofertë-kërkesë. Pavarësisht nga vlera e bonove dhe e lekëve të privatizimit, të grumbulluara, ankandi mbyllet në afatin e përcaktuar në pikën 3, kapitulli II-B) të këtij vendimi."

Në kapitullin III bëhen këto ndryshime:

Pika 1 riformulohet si më poshtë:

"1. Rezultatet përfundimtare të ankandit hartohen nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit në pesë kopje, njëra prej të cilave mbahet në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, dy i përcillen Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, një shoqërisë dhe një qendrës së regjistrimit të aksioneve."

Pas pikës 11 shtohet pika 11/a me këtë përmbajtje:

"Për realizimin e procedurave të llogaritjeve nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, qendra e informatizimit financiar detyrohet të dorëzojë pranë kësaj agjencie të gjithë bazën materiale të përftuar nga programi i privatizimit masiv, dokumentacionin, programet e përdorura për këto llogaritje, si dhe dokumente të tjera, që kanë shërbyer në realizimin e këtij procesi dhe që do të sigurojnë vazhdimësinë e punës nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit."

Mjetet financiare, që nevojiten për ngritjen e njësive informative pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe për kryerjen e veprimeve për llogaritjen e rezultateve të privatizimit për shoqërinë tregtare, të sigurohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, nga fondi i krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.416, datë 7.9.1998 "Për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nga privatizimi i shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë."

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko